



AGRON
AGOLLI

ERË E
POEZI
VENDLINDIES



891.883-1



DSH-1
A37

AGRON AGOLLI

ERË E VENDLINDJES

poezi



SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

Shtypur Drejtoria Poligrafike
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1976

KANAN, DJALË I RI

— *Heroit tē Popullit Kanan Mazes.*

Kur vinin kobshëm vaporët
mbi detin me valë,
u tund e gjithë Barçallaja
tē zgjodhën komandant.

Ç'u vërvite mbi armikun
si shqipja me krahë,
në ballë tē kish Labëria,
Kanan, trim i rrallë.

Yjet këputen e bien
zjarr mbi Labërinë,
me nj' grusht trimash Kanani
godet mbretërinë.

Mes kuvendit tē Njëzetës
Kanani prerë flet:
«Nder e Shqipërisë, vëllezër,
lipset ta mbrojmë vetë!»

O Kanan, grykat e thella
të lodhur s'të panë:
«Djemtë i kam zgjedhur vetë,
të gjithë trima janë!»

Po q'je ti që s'të tremb vdekja
nishesh e rrëthon Kotën
dhe nuk pyet se gjëmon topi
e gjylet të dogjën?

Garnizon i Kotës shkretë,
fara më t'u shoftë!
U mbyt Kanani në gjak,
nofullat copë-copë.

C'bën kështu, more Kanan,
t'u prish bukuria:
«C'ka se mbeta unë pa gojë,
të rrojë Shqipëria!»

Dhe ndihej zëri yt,
lule e burrërisë,
nën shtëpinë strehëgrisur
edhe pranë avllisë.

Gurgullon gjaku buronjë
u ngjen ujvarat,
i kuq flakë qe perëndimi,
gjak pikon dhe hëna.

Godet keq top i mallkuar
pushka jote flamur,
mizëri e huaj s'të ndali,
luan në furtunë.

E s'u tunde, Kanan,
luan mali vallë?
Si dëborë zbardhët ndër qafa
tallagane e bardhë.

Më këmbë u ngrit Labëria
gjithë sokëllimë,
djemtë si shkrepëtimë rrufeje
malet se ç'u nxinë.

Pranë t'u ul Avni Rustemi
të lëmoi ballë,
liria shpatë e flamur
t'u ul përmbi plagë.

Shkel mbi shkëmb ku ece ti
me hapin e rëndë,
dua fjalët që t'i mbledh
të të thurë një këngë.

Po ku je, si të të gjej
sot që vij ndër male,
se je futur thellë në zemër
e në çdo petale.

O, po q'them kështu me vete
ja tek flasin shtigjet,
kish një zemër si të luanit,
të rrepta mendimet.

Rrugës malit nga ke shkuar
bredh e s'të zë dot,
ta shoh ballin tërë rrudha,
sytë me yje plot.

Dhe më duhet kaq shumë
të rend vitevë,
të mbledh copërat e jelekut
grirë prej plumbave.

Kur e nis köngën pér ty
shtruar me longarë,
syth i rrushit pikë-pikë
shkrihet duke qarë.

Oh, këtë dhembje kaq të madhe
si ta mbaj në zemër,
fytyra jote e çelur
mbi strall gdhendur.

C'është ky zë që vjen nga Shkoza
dhe më hyn në shpirt?
Kanani ballë i betejës
udhët mbush me dritë.

Si një mal në mes vargmalesh
pate shokë shumë,
kishe Sadon e Zigurin,
Selamin me gunë.

Nëpér gërxhe ndeshen retë
majash hekur hedhin;
si pér sulm mblidhen fshatarët,
Kanan, të përcjellin.

Të përkundi shkëmbi sertë
ku bie dëbora,
u rrite në suferinë
ndaj s'të dridhej dora.

I vunë çetës emrin tënd
u bë tramundanë,
malet për ty kur dëgjuan
kryet se ç'i varë.

Dallgët që vijnë nga deti
bregut murmurijnë,
ligjërimin e ndal era
se fle, Kanan, tinë.

U ngrit djali yt i vogël
armët brezit i ngjeshi,
shqotë e bënë partizanët
në çdo grykë e shteg.

Trimërinë këndoi me fyell
bariu në mal,
këputi dafinë e lule
t'i çojë përmbi varr.

Lulëzon bregdet i jugut
portokallet çel,
Kanan Mazeja nga Shkoza
larg vështrimin tret.

Si vargan vijnë fshatarët
pranë bustit rrinë,
për ty e përvëlon malli
gjithë Labërinë.

Na merr malli të të shohim
të varesh stanit,
siç zbrisje dikur me djemtë
nga shkallët e malit.

Si të shkruaj se nuk je?
Jo, s'them dot, Kanan!
Ti si këngë vjen nëpër vite,
ngrihesh si vigan.

ERË E VENDLINDJES

Vjen devollka grykës malit
sjell me vete kundërmim,
zukat bleta lules barit
panjë e egër fëshfërin.

Varen kallëzat anës rrugës
kryeartëza po brufullon,
zjarr i punës vjen mes shtrungës
kor i drapërinjve ushton.

Fry devollkë, varu fushës
ku lodron kalliri pjekur,
zgjidhja, moj, shaminë prej gushës
asaj vajzës flokëdredhur!

Ma sill mua gjeologut
ta mbush plot me lule mali

dhe ta var te rrjedhë e kroit
ku zbuloj ajkë minerali.

Fry devollkë, erë e dashur,
fry devollkë, erë e mirë,
mbrëmë unë fjeta nën gëmusha
piva qumësh me barinjtë.

Brufullon zog' i beharit
trembet dhe merr arratinë,
kombajneri i këndon grurit
unë këndoja kampionin tim.

Hajde erëz e vendlindjes,
që më zbret qafës nga larg,
shkunde vesën e kallirit
unë ta mbledh, ta fut në varg,

E菊ie s' ëllës që blloj obo s' bërtig ob
dixhikollivat s' vlijed s' n' kallirjet ob
tuzenit s' tira s' tira s' tira s' tira s' tira s'
lumbarat jetët qendrë s' dëllur qëllat ob
strukturat qendrët s' tira s' tira s' tira s'
tuzenqat tuzenqat tuzenqat tuzenqat tuzenqat

DUKE LEXUAR VEPRËN E 19-të

Mbrëmë te ne nuk pati gjumë,
komisari lexoi veprën e nëntëmbëdhjetë,
poshtë deti trazohej e mbushej me shkumë
mbi tytën e topit era frynte qetë.

Mbrëmë më pranë të patëm, nënë Parti.
Fol, të lumtë goja, o komisar!
Zemra si një zogëz na hidhet në gji,
sytë prej gëzimit na ndizen si zjarr.

Çdo gërmë e çdo fjalë predhë e silurë,
çdo predhë në ballë të revizionizmit,
çdo faqe një betejë e një flamur,
çdo radhë udhë e kuqe drejt komunizmit.

Dhe u bëmë më të fortë pranë topave
e më mirë i niveluam qeparët

dhe thamë: «Që t'u thyejmë dhëmbët bllo-
kadave
barutin ta ruajmë të thatë, e të pastra
armët!»,

MALEVE SHQIPTARE

Përjetësish ju dua, male,
o kalorës gjigandë
që ndër epoka madhështorë do mbeteni!
Male hijerëndë e kreshtëbardhë gjer në re,
ju këngëtarë luftërash
e vuajtjesh;
ju djepi,
shtëpia
dhe kështjella e shqiptarëve!

FRYN ERË E MALIT

Fryn era e malit petalet i shkund,
fryn erë e nëntorit flamurin përkund.

Në honet e thella porsi shtigje lufte
i shoh partizanët kur hidhen në sulme.

Fryn erë e malit dallgëzon grunaja
e shoh socializmin tek ngjitet ndër majë.

Fryn erë e nëntorit mbi metalurgji
sa lart që na ngjite, e shtrenjta Parti!

QAFA E DEVIJES

Vijnë e shkojnë vitet
si malet në radhë
te qafë e Devijes
ç'bën, o komisar?

Era shpërndan gjethet,
bari ngriu kallkan,
vallë t'u thanë plagët,
djal' o komisar?

Toka mëmë të mori
si djalin e saj
e nga plagët lulet
çelën përmbi mal.

Në qafë të Devijes
hapin sot e ndal,

tek më digjet xhani
lule lë plot mall.

Vijnë e shkojnë vitet
frym erë e Lenijes
tek re, komisar,
në qafë të Devijes.

17



S H Q I P È R I S È

Reliev i thyer në formë gjashtëkëndëshi
mbushur me vargmale
si rrudhat në ballin e popullit tim
plot halle.

Këngë epike thurur mbi stërrall,
një elegji e dhimshme për të rënët
shkruar me gjak,
relievi yt, portret i shqiptarit,
që shekujt i ka pritur gjithmonë me shpatë.

MOTIV PËR FSHATIN E RI

Erdhi pranvera e po bulojnë pemët
bari i hollë rritet në lëndinë,
zabeli u mbush me zogj e me çerdhe,
gushkuqi këngës ia thot' në kabinë.

Zhurmëron përroi në fund të fshatit,
çobenjtë nga vathat lëshojnë bagëtitë
kështu s'ke qenë kurrë, o fshat i dashur,
rrethuar me pemë edhe larë në dritë.

Afsh i tokës ma mbush kraharorin,
plisi thërrmohet nga plugu i mprehtë,
dielli si një lëmsh rrökulliset malit,
vesa shkëlqimtare nga lulja rrëshqet.

Rrapëllin traktori arave me vlagë,
grupi i estradës shfaqjen do luajë sot,

lëmenjtë presin sa të piqet gruri
e kooperativa depot t'i mbushë plot.

I prishëm sinorët e mezhnikët i shkulëm
siç shkulim nga koka të vjetrat zakone,
bashkë i kullsim ndër parcela lopët
e nuk i mbajmë për briri me porozhde.

Përroi shket në shtratin e vjetër,
përrroi mbi zaje e gurë zhaurin,
bashkë me ujin e pastër të burimit
rrjedh kënga fshatare për Partinë.

ATJE KU BARI MBIN E MBETET I GJELBËR

Atje më pikoftë djersa
tek ajo rrasë me gurë të sertë,
ku mbështeti kokën kufitari Selfo,
kufitari Selfo ra një natë me erë!

Ç'më merr malli sot për ato vise
ku bari mbin e mbetet i gjelbër,
ku çdo sekondë sfidë i bëhet vdekjes
e në çdo stinë të bardha janë edhe

netët.

KËPUCARIT PLAK

— Zyke Malajt, që e vranë gjermanët duke qepur këpucët e partizanëve.

Gjermanët shtëpinë ta dogjën, xha Zyke,
gjermanët ta dogjën dhe plevicën me kashtë,
ti vetë qepje këpucët e partizanëve
te streha e vjetër ulur nën hajat.

S'të erdhi keq për shtëpinë e djegur
po rrije menduar aty mbi murriz
ku të rriti nëna me një dorë misër,
ku të rriti nëna me një fshere gjizë.

Babanë që pate ta treti kurbeti,
fëmijnia jote shkoi me lotë në faqe,
dhe rrudhat e ballit sot flasin vetë
se dhe rininë të vështirë e pate.

Një ditë sa kishte hyrë prilli
te streha e vjetër erdhën ca gjermanë,
të thanë: «Këpucar, ku janë pàrtizanët?
Po s'na tregove të rropëm të gjallë!»

Nëpër buzë të shkoi një buzëqeshje e lehtë,
urrejtja për ta shpërtheu si tufan
dhe tek vështroje tutje përmbi male
u the: «Ja ku janë, shkonit në jua mban!»

Njëri prej tyre të qëlloi nga prapa
ti në dorë shtrëngoste çekanë.
Ike këpucar e na dhembi zemra
po idealin tënd ata kurrë s'e vranë.

BORIZANIT KUTO

Qarrishtë, moj Qarrishtë e madhe,
qarrishtë me lisa e me gurë të sertë,
na e mbajte partizanin Kuto,
borizan' e vogël që printe n'betejë.

Eh!... Bori e tij sa mirë që binte,
kush s'u hodh me të në flakë e zjarr,
me zërin e saj në Tendë na ranë shokët
e lulet e kuqe mbinë në Mezhgoran.

Po ra në vjeshtë, kur gjethet po zverdhnin,
dimri mbi male qeleshen kish varë,
ra, po zëri i tij mbeti nëpër vite
si një thirrje e rreptë «Para partizanë!»

PORTRËT MINATORI

Mbi supet e tua u var pleqëria
e gjunjët filluan të të dridhen nga pak
po ti nuk u ndave nga galeria,
xha Myrteza, minatori plak.

T'u shtuan rrudhat në ballin e gjerë
e flokët e zezë t'u mbushën me thinja,
po punën ende ti nuk e ke lënë
vagonin me krom transporton mbi shina.

I shoh duart e tua vrarë e plasaritur
nga puna e rëndë e galerisë,
shoh fytyrën tënde me bulëza djersit
tek prodhon bukën e industrisë.

Si s'the një herë «Vate djalëria»,
si s'të dëgjuam një herë të psherëtish
po hyn e del çdo ditë nga galeria
sikur hyn e del nga porta e shtëpisë.

VIJ ME LEJE NGA USHTRIA

Fryn me duf era prej fushës
ku folenë ka çafkëlori
tek i shpërndan flokët gushës
ti këndon, moj buzëflori.

Vij me leje nga ushtria
në fshat korret grurë i ri,
në mes shoqeve të mia
të pashë ty, moj mezkalli.

Unë të pyeta për fshatarët
ti për shokët në ushtri,
tek kalonim mbi plitharët,
hëna zbret, në sy të rri.

Ndër lëmënjtë ku gruri shihet
shkoj e vrahun kthej me sfurk,
kënga e draprit arës ndihet
era bykun qoshes struk.

K U F I T A R È V E

Njësh me tokën jemi bërë
mbështetur nëpër transhe,
përmbi mal ku shkrep rrufeja
mblidhen retë si ergjele.

Era fryn e shqota s'ndalet,
gjoks çelik na ke atdhe
dritë e vetëtimës varet
si nëpërkë përmbi ne.

Shqekëz thep kemi rrafshuar
syrin pishë e mbajmë atje,
dhe në flakë të vetëtimës
jemi gati të shtiem ne.

Majës malit flokon bora
Buna del nga shtrati vet,

na u zbardhën dhe kapotat
bora shkrihet mbi helmetë.

Ne që stinët këtu i presim
mbi brinjën e ngrohtë të dheut,
populli kështu na quan:
«Syri i pushkës së atdheut».

SINFONIA E KOHËRAVE

S'pushuan së rëni daullet
që mbartnin sinfonitë e kohërave.
Kur binin trimat
me to i përcillnim,
te kryet i vinim lule me gjajtan,
pranë maleve hidhnik vëtëm krisma
e dridheshin daullet lëkurë kau.
Nga dorë e ustait koskë e azgan
sot mbi kreshta bien daullet krenare.
Nëpër krisma shpërthen socializmi si gonxhe
buçet kënga e gëzueshme e jetës shqiptare.
Daulle të lashta,
daulle të reja,
gjëmoni pas punës, në festa!
Sinfonia e kohërave rritet e rritet...
Gëzimi korr bollëkun si vjeshta.

VITE QË SJELLIN BLERIM

— Qafës së Qarrit —

Shekujt mbi ty përplasën veç erën,
armiqjtë plumbat hodhën pa pushim;
nga marazi deshën të të zhduknin
po ti e pabindur qëndrove,
qafë me dushqe e me gurë të zinj.
Te ti shumë shkojnë e vijnë
pleq, të rinj,
dikush ia merr një këngë shtruar,
dikush hap kutinë e dredh një cigare...
Vitet e Partisë
vijnë e të veshin me blerim,
moj Qafë e Qarrit,
qafë me dushqe e gurë të zinj.

QYTETIT HERO

Kaq vjet mbi ty u vërsulën turqit
e s'të mposhtën dot, o qytet i lashtë,
tek çaheshin muret derdheshin jeniçerët
po shqiptarët kokat ua prisnin me shpatë.

Rëndë-rëndë erdhën pashallarët
hipur përmbi kuaj arabë me yzengji,
po i lanë koskat skërkave të tua
se shpatëngrehur ke qenë gjithmonë ti.

Një verë u ngrit e erdh' vetë sulltani
t'u kanos me topa «trim i anadollit»,
kur e pa që s'binin kordhëtarët, iku
e nga marazi vdiq në mes të Stambollit.

Obelisk të lartë i ke ngritur
atij, që lirinë mbrojti pallëzhveshur

e që s'iu tremb asnjëherë mejdanit
se zemrën dhe krahun ia bëre të hekurt.

Vitet shkojnë e nga rrjedhë e tyre
emra mbretërish të dëgjuar fshijnë,
ndërsa ty, Qytet i lashtë Hero,
koha vjen e ta shton lavdinë!

KU MË THËRRET ATDHEU

Kam mbështetur pushkën mu në gjoks,
supeve kam hedhur pelerinë
jashtë fërshëllen veriu i ftohtë
e përplas mbi mua suferinë.

Nuk ke ç'më bën, moj erë e marrë,
nuk më mposht dot, moj suferinë,
rrugën ma ndrit i kuqi ideal
e në zemrën time kam Partinë.

Sonte kam shërbim te qafë e malit,
ku kaloi korrieri partizan,
që i rridhte gjaku nëpër plagët
e mbatej mbi borën si gjerdan.

Kam mbështetur pushkën m'u në gjoks
dhe yllin e kuq e mbaj ballit,
karakoll më ka kjo tokë e dashur,
karakoll më ka sot qafë e malit.

POPULLIT TIM

Populli im lidhur si vargmalet
mbi sup i ke pritur rrufetë,
kur s'ke pasur bukë ke përtypur brengën
e dorën askujt is'ia shtrive në jetë.
Populli im zemërgjerë si deti
sofrën shtruar për miqtë e ke pasur.
Sa herë armiqtë kufijtë të kanë prekur
armët ngjeshur i ke mbajtur.

ME GJUHËN E PUSHKËS

Në na sulmoftë një ditë armiku
ai që halë në sy përherë na ka,
ne s'do ta presim jo me lulet e malit
për të kemi vetëm një dhuratë:
barutin dhe plumbin e nxehtë ballit.
Gjumi s'na ka zënë kurrë të shkujdesur
ndjenja e detyrës na e shton merakun
se e dimë mirë:

«Kush kokën e vuri mbi dafinë
armiku në fyt ia ka hedhur lakuń».
Pozicionet i kemi te vija e parë,
pas çdo guri e kepi të lartë
ku zbret pranvera në llogore.

Po hodhe këmbën, armik, do të të djegim
me zjarrin e madh të luftës popullore.
Në na sulmoftë një ditë armiku,
që vjen me mendime më të errëta se nata,
ne do t'i përgjigjemi vetëm me gjuhën e
pushkës.

K O M A N D A N T I T

Komandant, mbrëmë çfarë kujtoje vallë,
kur ne sulmin nisëm mbi kodrinë?
E shoh, pleqëria supeve t'u var,
po ky sulmi ynë ç'të solli rininë.

Mendoje për shokët që betejës ranë
kur nga trupi gjaku u rridhte curril,
po ti komandant në sy dritën mban
e në buzë këngën që mbeti e dliërë.

Dhe na ndizet zemra tek të shohim ty
kur sulmon me ne përmbi kodrinë.
Si s'u lodhe një herë, o komandant,
po gjithnjë të patëm krahnë marrshim.

Sytë të flakërojnë kur ne zëmë pritën
e ashtu siç je derdhesh tutje rrugës.

Pa heq dhe granatën, që e var te brezi,
e hedh mbi «armikun» si në kohë të luftës.

Mbrëmë, komandant, ç'tu kujtua vallë,
kur ne si rrufë u hodhëm mbi kodrinë?
Patjetër mendoje për shokët e vrarë,
shokët që bajrak mbetën për lirinë.

PENSIONISTËVE VULLNETARË NË HEKURUDHË

Ju shohim tek lidhni shamitë e bardha
e hapin e hidhni me ne në trase,
ju shohim në rreshtat e para të brigadave
e djersën fshini shpesh balleve.

Ju pensionistë, ju thesar i çmuar,
më kot vitet u sjellin pleqërinë.
Jo, nuk u plakërka zemra juaj çelike,
s'mplaket kollaj zemra që rreh për Partinë!

Kështu të bashkuar historia na gjeti
në kujtimet e viteve u vjen djalëria,
o pensionistë flokartë e të thinjur,
ç'lezet ju paska sot kjo pleqëria!

Pas pune kuvendin për norma e nisni,
shqetësimi juaj zemrat peshë na i ngre,
ju me rininë këngën merrni shtruar
këtu pranë Shkumbinit në këmbët e maleve.

V O G È L U S H E S

E pashë kur i ngrinte duart lart
si dy biskaja të porsaçelura,
mbi qelibarin e syve të saj
kish nisur blerimin pranvera.

Tek buzëqeshte
nga ëndrrat e bukura
fluturonin pëllumba të bardhë.
Ajo belbëzonte
e në buzët e njoma
flakëronin lulekuqet.

E pëershëndeta vogëlushen
e tek largoresha
mendoja se si pranvera
kish hyrë e tëra
në qënien e saj të pastër.

GJËMIMET E MAJIT

Shihni, shihni lart,
në qiel fishekzaret dredhojnë si rrufe,
kudo buçet këngë,
 është maj
 e parakalon klasa.

Me të jam në radhë
si ushtarë i së njëjtës llogore,
 jam pjesë
 e gjaku i saj
 me të njëjtën ngjyrë.

Sot hapin e hedh me punëtorët,
e ndieni si tundet dheu?
Janë gjëmimet e revolucionit,
eci në kolonë me klasën
që ballin ia ndrit ideali.
Vëllezër

fshatarë,
poetë,
ushtarë,

futuni të gjithë në radhë me klasën!
se grushti i saj shemb botën e vjetër
e deviatorët pa drojtje i flak.

Ky është maji
i kuq,
i kaltër,
plot diell,

maji i punëtorëve,
që zëri i tyre buçet kontinenteve.
Ja tek parakalon duararta,

e pathyeshmjë,
e ndërgjegjshmjë,
sulmuesja.

Ajo që luftën fitoi
e ngrë në qìell korpusë të lartë,

ajo që rrugën e saj drejtë komunizmit
e bën të metaltë.

Sot të gjithë në rrugën e klasës,
në rrugën që prin Partia.

R O Z A F È S

Rozafa jonë, Rozafë e lashtë
ngritur si një sfinks përmbi xhade,
gjithë sa t'u derdhën mbi muret e lartë,
bijtë e tu të rreptë i shtrinë përdhe.

Për bijtë ke qenë strehëz e mburojë
ndërsa pér armiqtë m'i llahtarshmi varr,
nga legjenda jote shumë qumësht pikoi
sa çelën lulet edhe mbiu bar.

Te ti kam ardhur e prapë do vi
të ecë mbi gurët e rëndë të daltuar,
e kur të kam pyetur, Rozafë, si fëmijë
shumë gjëra ti më ke treguar.

Më ke treguar një ndodhi të vjetër
se si trimat e tu pallëlarë
s deshën të bëhen as princër as mbretër
po deri në fund mbetën kështjellarë.

V L L A H E S

Tringëllin malit një zilkë
nga ato të stanit.
Nënë, dil mos është Nasta,
vajza e çobanit.

Si s'e njeh ti, nënë, Nastën,
vllahen e bukur,
që mbushte ujë te burimi
dhe ikte si flutur?

Kur ne ishim fëmijë,
aty nën shtëpi,
unë mbolla një plep të vogël
ajo një qershi.

Dhe u rritën të dy bashkë
plepi dhe qershia,

s'i thau vapë e korrikut,
s'i shkuli stuhia.

Ne ndoqëm shkollën
katër vjetë bashkë,
ajo erdhi agronomë
unë mësues në fshat.

Atëherë kish çel qershia
ish mbushur me lule,
desha Nastës një kurorë
t'ia hidhja mbi hupe.

Tringëllin malit një zilkë
nga ato të stanit.
Nënë, dil mos është Nasta,
vajza e çobanit.

PEISAZH DIMRI

Jashtë ra dëbora papritur
majat e maleve gjelbërim nuk kanë.
Vjeshta i fshiu gjurmët e saj të fundit
e fëmijët
bredhin të gëzuar pas fjollave.
Luleboret që vijnë në dritare
me petalet e kumbullës ngjajnë.
Sot është dimër.
Bie dëborë e fryn erë
pojeta rrjedh e vrullshme.
ecën si në pranverë.
Minatorët vijnë nga galeritë
e i pret urbani i fundit,
në mal ngjiten druvarët,
fërfëllon thëllëza buzë lumi.
Natyra veshi vello nusërie
deti ruan ngjyrën e tij gri.
Po të mundja,

tani,
do mblidhja tërë bardhësinë e kësaj dite
e në zemrën time ta mbaja
përgjithnjë!

LUMI I PESARIT

zëhoq i ngrënët e qendrës së vjetër e zotit
Brended em enët jofordit i t' shenjtë muk
nënët se saj e zinxhurillët është që n' e
Brended jashtë s' e mbështetë mënyrët si

N I N U L L È

— Nipit të vogël, Altin —

Hapi syçkat, o Altin i vogël,
se dikush në xham po na troket,
është një mik që vjen nga rrugë e largët
e me rreze ty të përshëndet!

Ja ku të është ulur pranë krevatit,
thuaji ndonjë fjalë që të dëgjojë
se pastaj gjyshja një histori,
trim i vogël, ty do të tregojë.

«Ka qenë dikur një vajzë e vogël,
kish emër të bukur sa të gjithë e dinin,
prindërit e saj luftonin në male
ajo mblidhë lule thurte trëndelinë.

Por e vranë, biro, te pragu i portës,
kur priste t'i kthehej nëna me babanë
e s'e pa më diellin, nuk e pa as hënën,
la vetëm lulet, s'e gëzoi beharë.»

Sa fëmijë, mor Alti, ka sot nëpër botë
që lindin, po diellin s'e shohin një ditë,
se i gllabëron kapitali i zi,
i shtypin esesët, i vrasin jankitë.
Dhe atë histori që të tregoi gjyshja,
për vajzën e vogël porsi gjeraqinë,
ta mësosh, biro, e ta mbash në zemër
se emrin e saj që të gjithë e dinë.

KUR KALOJ MES LOPËVE

Dikur çoban i fshatit kam qenë
e nëpër male i kulloja lopët,
sot që ngas traktorin rëndë-rëndë
s'mbaj mëri kur shaka bëjnë shokët.

Veç diçka më zgjon koha e shkuar,
s'di si vjen edhe më djeg si zjarr
malli për fshatarkën syshkruar,
që ia kish qejfi t'më quante lopar.

Mes tufës kur shkoj shpesh më duket,
se thellë në sytë e tyre ulur,
është ende ai lopari i vogël
e buzëqeshjë e fshatarkës së bukur.

SHOQEVE TË FSHATIT

Vajza të bukura të fshatit tim,
që kallzat e grurit i mblidhni në arë,
e dini, shamitë e bardha që mbani
me krahë pulëbardhash ngajnjë.

Vajza punëtore të fshatit tim,
që arave dilni me natë,
kokrra e grurit për ne është e shenjtë
se rrënjet i ka në gjak.

Vajza ushtare të fshatit tim,
mbrëmë kur zbrisnit nga majë e praruar
ç'u mbeti në buzë këngë partizane:
«Malet me blerim mbuluar».

L I R I K È

Tek rrasa me gurë radhitur,
ku fryn detit një puhi,
folenë e tyre kanë ngritur
dy pëllumba pendëgri.

Çerdhen dielli se ç'ua ndrit
erë e bregut ua freskon,
valë e detit ua flladit,
hëna bri mbi ta pushon.

Pranë dritares kur qëndrojnë,
dy pëllumbat pendëgri,
një kujtim të ri më zgjojnë,
që rri mbi qerpikët e mi.

TANI QË JE NËNË

Shpesh ty kësaj rruge të kam parë
shkon e kumbullën prek me dorë,
petalet e bardha të bien mbi krela,
kumbulla e çelur të vuri kurorë.

Një kurorë të tillë do të sillja dhe unë
se fëmijë kur ishim shpesh me ty këndoja...
Të shoh e çuditem sa shumë qenke rritur
vajza e vogël s'të lëshon nga dora.

T A M I R È S

— Vajzës që e torturuan xhelatët
kilianë.

Antenat e botës mbrëmë ç'fjalë shpërndanë?
Ndoshta klithmën tënde
kur të torturonin
e të hiqnin zvarë,
Tamirë, e vogla Tamirë.
Kishe dalë te porta
e prisje babanë
që ta morën esesët
e në burg ta vranë,
Tamirë, e vogla Tamirë.
Xhelatët mbi ty
qëlluan me hekur,
ti katër pranvera s'i kishe mbushur mirë...
E pashë perëndimin,
kish ngjyrë të përflakur
lyer nga gjaku yt
që rridhte curril.

Antenat e botës mbrëmë ç'fjalë shpërndanë?
Ndoshta klithmën tënde
kur të torturonin
e të hiqnin zvarë,
Tamirë, e vogla Tamirë.
Gjaku yt i pastër
sot kërkon shpagim.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Kanan, djalë i ri	3
Erë e vendlindjes	10
Duke lexuar veprën e 19-të	12
Maleve shqiptare	14
Frym erë e malit	15
Qafa e Devijes	16
Shqipërisë	18
Motiv për fshatin e ri	19
Atje ku bari mbin e mbetet i gjelbër	21
Këpuçarit plak	22
Borizanit Kuto	24
Portret minatori	25
Vij me leje nga ushtria	26
Kufitarëve	27
Sinfonia e kohërave	29
Vite që sjellin blerim	30
Qytetit Hero	31
Ku më thërret atdheu	33
Popullit tim	34
Me gjuhën e pushkës	35
Komandantit	36

Pensionistëve vullnetarë në hekurrudhë	38
Vogëlushes	39
Gjëmimet e majit	40
Rozafës	42
Vllahes	43
Peisazh dimri	45
Ninullë	47
Kur kaloj mes lopëve	49
Shoqeve të fshatit	50
Lirikë	51
Tani që je nënë	52
Tamirës	53